



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:092258  
Datë: 13.05.2024  
Numri i dokumentit: 05677096

K.DH.SH.II.nr.140/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Crimson Financial Fund L.L.C. (CFF) me seli në Prishtinë, rr.“Pashko Vasa” nr.22, e përfaqësuar nga K.S., kryeshef ekzekutiv, kundër debitorit 1. N.T.P.“Penelope” me seli në Prishtinë, rr.“Hilmi Rakovica” blloku 36-7-1, me pronar Sh.R. (bashkëkredimarrës) dhe 2. N.T.SH.“Alba – Oil” me seli në Kaçanik, rr.“Djeneral Jankovic” me pronar Sh.R.1. (garantues i parë), me bazë juridike përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të parë, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2121/2022 të datës 31.10.2023, me datë 13,05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit të parë N.T.P.“Penelope” me seli në Prishtinë, rr.“Hilmi Rakovica” blloku 36-7-1, me pronar Sh.R. (bashkëkredimarrës), ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2121/2022 i datës 31.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2121/2022 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P.“Penelope” me nr. të biznesit 70706564, të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.715/2022 të datës 10.06.2022 të lejuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.715/2022 të datës 10.06.2022 të lejuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori i parë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të

gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që aktvendimi i ankimuar të anulohet, të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor si i kundërligjshëm dhe i pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e debitorit të parë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ashtu që aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit të parë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Crimson Financial Fund L.L.C. (CFF) me seli në Prishtinë, rr.“Pashko Vasa” nr.22, e përfaqësuar nga K.S., kryeshef ekzekutiv, me datë 10.06.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit 1. N.T.P.“Penelope” me seli në Prishtinë, rr.“Hilmi Rakovica” blloku 36-7-1, me pronar Sh.R. (bashkëkredimarrës) dhe 2. N.T.SH.“Alba – Oil” me seli në Kaçanik, rr.“Djeneral Jankovic” me pronar Sh.R.1. (garantues i parë), në bazë të Kontratës për kredi biznesi nr.00/439 të datës 29.05.2015, Kontratës mbi Pengun për Kolateralin e luajtshëm 1-439, e datës 29.05.2015, konfirmimi i regjistrimit të pengun në MTI nr. R-20220420-385.

Përmbartuesi privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.715/2022 të datës 10.06.2022, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorëve në bazë të dokumentit përmbartues, duke vlerësuar se dokumenti përmbartues i plotëson kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori i parë me datë 05.07.2022, ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se ka njoftuar kreditorin se N.T.P. me pronar Sh.R. për kredinë që ka qenë e regjistruar në mes të klientit – garantuesit blerësi i patundshmërisë të jetë Sh.R. me pronar në Kompaninë “Alba Oil”. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 18.07.2022, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2121/2022 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.P.“Penelope” me nr. të biznesit 70706564, të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.715/2022 të datës 10.06.2022 të lejuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.715/2022 të datës 10.06.2022 të lejuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se debitori nuk e ka bërë të besueshëm prapësimin me prova konkrete si dhe nuk i ka përmbushur asnjërin nga kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 71 lidhur me nenin 69.4 të LPP-së, tutje ka arsyetuar se në rastin konkret propozimi për përmbarim është paraqitur në bazë në bazë të Kontratës për kredi biznesi nr.00/439 të datës 29.05.2015, Kontratës mbi Pengun për Kolateralin e luajtshëm 1-439, e datës 29.05.2015, konfirmimi i regjistrimit të pengun në MTI nr. R-20220420-385, të njëjtat të paraqitura në origjinal dhe si të tilla përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbarimi, ngase i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 22 paragrafi 1.7 a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit të parë se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, për faktin se në rastin konkret gjykata ka lejuar përmbarimin duke u bazuar në Kantatën e Pengut 1-439 të datës 29.05.2015, e cila është regjistruar në regjistrat përkatës e kjo vërtetohet nga Konfirmimi i regjistrimit të pengut pranë MTI-së, R-20220420-385, e që me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1.7.a të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, theksohet se dokument përmbarues është: *“kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut”*, e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbarimit. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka lejuar përmbarimin gjegjësisht ka refuzuar prapësimin e debitorit të parë ngase sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore përmbarimi lejohet në bazë të dokumentit përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit të parë por të cilat kanë rezultuar si të pathemelta dhe nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe se për këtë arsye gjykata ankimore ka vendosur që ti refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së.

Numri i lëndës: 2024:092258  
Datë: 13.05.2024  
Numri i dokumentit: 05677096

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.140/2024, me datë 13.05.2024

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi